



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 4146/1 prot.

Tiranë, më 21.07.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1335, datë 15.04.2009.

SHOQËRISË “MINIERA E KROMIT KATJEL” SH.P.K
Katjel, Rajcë, Librazhd, Prrenjas, Elbasan

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “MINIERA E KROMIT KATJEL” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1335, datë 15.04.2009, për mineralin krom, në Objektin “Katjeli Jugor”, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, me anë të shkresës Nr. 850 prot. AKSEM, datë 09.06.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 4146 Prot., datë 09.06.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1335, datë 15.04.2009, për mineralin krom, në Objektin “Katjeli Jugor”, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, pas problematikave serioze të ndodhura kohët e fundit në objekt, si rezultat i përmbetjeve të nivelit Hz +428, i vetmi nivel në të cilin kryhet veprimtari minerare. Pas disa inspektimeve të AKSEM në objekt, është vërejtur se kushtet teknike janë në gjendje të rënduar, me prani të shtuar të ujërave dhe llumrave, deformim të armaturave mbajtëse dhe kapacitet të tejmbushur të sistemit të pompimit, çka e bën të pamundur zhvillimin e veprimtarisë normale pa rrezik për jetën e punonjësve nga Hz + 428 deri në nivelin e pusit Hz +655.

Propozimi i **Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera**, është i mbështetur në Nenin 23, të Ligjit 135/2016, datë 22.12.2026, si dhe në perputhje me Nenin 47, pika 1, gërma “dh” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1335, datë 15.04.2009, për mineralin krom, në Objektin “Katjeli Jugor”, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, që shoqëria Juaj zotëron.**

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Në zbatim të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 49, pika 1, si zotërues i lejes minerare keni detyrimin të zbatoni planin përfundimtar të mbylljes së aktivitetit minerar, rehabilitimin e mjedisit për sipërfaqen e prekur nga aktiviteti minerar dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, të miratuar nga struktura përgjegjëse AKBN.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1335, datë 15.04.2009, për mineralin krom, në Objektivin "Katjeli Jugor", Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

BELINDA BALLUKU

**ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
CENO KLOSI**

